

DAC_OTH_02: Komunikimet e brendshme dhe të jashtme

Shënim

Si parim i përgjithshëm, të gjitha mesazhet e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit MC tek NEMO.

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
1.1. Qeverisur / E rregulluar nga.....	3
1.2. Mjetet dhe protokollet e komunikimit	3
1.3. Procedurat shoqëruese	3
2. Procedura.....	3
2.1. Komunikimi NEMO – Ofruesit e Shërbimit MC	3
2.1.1. Principet e komunikimit.....	3
2.1.2. Lista e shpërndarjes	4
2.1.3. Përmbledhje e mesazheve midis NEMO- Ofruesit të Shërbimit MC	4
2.1.4. Komunikimet e jashtme midis NEMO – Ofruesit e Shërbimit MC.....	4
ALPEX_Exc_01: Arritja e Kufijve të Lejuar – Hapja e librave të urdhërporosive	4
ALPEX_Exc_03b: Vonesa e mëtejshme e Seancës së Bashkimit të Tregut.....	6
ALPEX_Exc_03b: Vonesë e mëtejshme e Sesionit të Bashkimit të Tregut.....	Error! Bookmark not defined.
ALPEX_Exc_04b: Ndarje e plotë e Bashkimit të Tregut lidhur me Rezultatet e Bashkimit të Tregut	Error! Bookmark not defined.
ALPEX_Exc_04b: Ndarje e plotë e Bashkimit të Tregut lidhur me dërgimin me vonesë të kapaciteteve ndërkufitare	Error! Bookmark not defined.
ALPEX_Exc_05b: Ndarje e plotë e Bashkimit të Tregut e njohur në avancë.....	Error! Bookmark not defined.

1. Hyrje

Kjo procedurë synon të përshkruajë parimet, përmbajtjen dhe palët e përfshira në mesazhet e përbashkëta të DAC, që duhet të dërgohen kur publikimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut vonohet ose gjatë disa situatave të veçanta të tregut apo incidenteve teknike.

Të gjitha oraret e përfshira në këtë procedurë tregohen si orare CET.

Në të gjitha mesazhet (të brendshme (ALPEX_InC) dhe të jashtme (ALPEX_Exc)).

1.1. Qeverisur / E rregulluar nga

- Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë (DACOA)
- Procedura NEMO- Ofruesi i Shërbimit MC
- Procedura Lokale

1.2. Mjetet dhe protokollet e komunikimit

- Email-et

1.3. Procedurat shoqëruese

- DAC_FAL_01: Menaxhimi i incidenteve
- DAC_SPE_01: Impakti i Ankandëve të Dyta
- DAC_FAL_02: Ndarje e Plotë
- Procedura lokale.

2. Procedura

2.1. Komunikimi NEMO – Ofruesi i Shërbimit MC

2.1.1. Principet e komunikimit

Komunikimi formal me shkrim, i zakonshëm për DAC, bazohet në procedurën e NEMO – Ofruesit të Shërbimit MC.

Prandaj, përmbajtja e përbashkët e këtyre mesazheve zyrtare është pjesë e Procedurës së NEMO - Ofruesit të Shërbimit MC, ndërsa detajet specifike që mund të shtohen nga NEMO janë pjesë e parashikimeve përkatëse.

Komunikimet zyrtare nisen nga Ofruesi i Shërbimit MC dhe mund të përshtaten dhe përcillen nga NEMO sipas procedurës NEMO – Ofruesi i Shërbimit MC.

Komunikimi zyrtar me shkrim përbëhet nga dy lloje të përgjithshme të mesazheve me email, siç përshkruhet më poshtë:

○ “Mesazhet e komunikimit të brendshëm” (ALPEX_InC):

Mesazhet e brendshme përcaktojnë rrjedhën e komunikimit nga Ofruesi i Shërbimit MC nëpërmjet NEMO-s, drejt OST-ve përkatëse dhe palëve të tjera të rëndësishme dhe të interesuara, që janë emëruar siç duhet nga Palët e DAC.

Këto mesazhe janë vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk do t'i përcillen Anëtarëve të Bursës.

○ “Mesazhet e komunikimit të jashtëm” [ALPEX_Exc]:

Mesazhet e jashtme përcaktojnë rrjedhën e komunikimit nga Ofruesi i Shërbimit MC nëpërmjet NEMO drejt OST-ve përkatëse, Anëtarëve të Bursës, CAO dhe palëve të tjera të rëndësishme dhe të interesuara, që janë emëruar siç duhet nga Palët e DAC.

Përpara se t'i përcjellë këto mesazhe të marra nga Ofruesi i Shërbimit MC, NEMO mund t'i përshtatë ato sipas parashikimeve të tyre përkatëse.

2.1.2. Lista e shpërndarjes

NEMO do të përcjellë mesazhet e komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm sipas listave dhe procedurave lokale të shpërndarjes.

2.1.3. Përmbledhje e mesazheve midis NEMO- Ofruesit të Shërbimit MC

Tabelat e mëposhtme ofrojnë një listë të të gjitha mesazheve të brendshme dhe të jashtme, që do të përcillen nga NEMO gjatë një incidenti të Bashkimit të Tregut, gjithashtu dhe kohën që këto mesazhe pritet të dërgohen. Përcjellja e mesazheve nga Ofruesi i Shërbimit MC tek NEMO dhe më pas nga NEMO tek OST-të dhe Anëtarët e Bursës do të bëhet në bazë të perpjekjes maksimale, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 5 minuta pas 'Kohës së Dërgimit'.

Tabela 1 – Mesazhet e Komunikimit të Brendshëm NEMO – Ofruesi i Shërbimit të MC, që dërgohen nga NEMO tek OST-te

Kodi i mesazhit (ID)	Emri i mesazhit të brendshëm	Ora e dërgimit	Procedurat e përfshira
ALPEX_InC_01	Bashkoju IC	11:00	DAC_Fal_01
ALPEX_InC_01	Bashkoju IC	13:00	DAC_Fal_02

Tabela 2 - Mesazhet e Komunikimit të Jashtëm NEMO – Ofruesi i Shërbimit të MC, që dërgohen nga NEMO tek OST-te

Kodi i mesazhit (ID)	Emri i mesazhit të brendshëm	Ora e dërgimit	Procedurat e përfshira
ALPEX_Exc_01	Arritja e Kufijve të Lejuar – Rihapja e librave të urdhërporosive	Sa më shpejt që të jetë e mundur mbas identifikimit të kufijve të Lejuar	DAC_SPE_01
ALPEX_Exc_02	Vonesë në publikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut	Sa më shpejt që të jetë e mundur	DAC_SPE_02
ALPEX_Exc_03b	Vonesë e metejshme e Sesionit të Bashkimit të Tregut dhe rrezik i ndarjes së Plotë	FD1 13:50 FD2 11:15 FD3 09:40	DAC_FAL_02
ALPEX_Exc_04b	Ndarja e Plotë	FD1 14:20 FD2 11:30	DAC_FAL_02
ALPEX_Exc_05b	Ndarja e Plotë e njohur në avancë	FD3 10:00	DAC_FAL_02

2.1.4. Komunikimet e jashtme midis NEMO – Ofruesit të Shërbimit MC

ALPEX_Exc_01: Arritja e Kufijve të Lejuar – Rihapja e librave të urdhërporosive

Në rast se çmimet arrijnë ose tejkalojnë kufijtë e lejuar, NEMO do të vendosë për fillimin e një Ankandi të Dytë, sipas procedurës DAC_SPE_01.

Sapo IC (Komiteti i Incidencës) të ketë rënë dakord për një kohë të përbashkët për të rihapur librat e urdhërporosive të NEMO për 10 minuta, Ofruesi i Shërbimit MC i dërgon NEMO mesazhin e jashtëm *ALPEX_Exc_01*.

NEMO mund të përshtatë dhe t'ua përcjellë këtë mesazh Anëtarëve të tyre të Bursës, OST-ve ose palëve të tjera të interesuara.

Shënim: Në rast se mesazhi *ALPEX_Exc_01* dërgohet pas orës 12:30, Ofruesi i Shërbimit MC do të dërgojë mesazhin *ALPEX_Exc_02*.

NEMO mund ta informojë tregun për vonesën në publikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut duke dërguar mesazhin *ALPEX_Exc_02*.

Titulli i mesazhit:

[ALPEX_Exc_01]: Kufiri i Lejuar u arrit- Rihapet libri i urdhërporosive

Përmbajtja e mesazhit:

Për shkak të tejkalimit të kufijve të lejuar të caktuara të çmimeve, një **Ankand i Dytë** do të zhvillohet.

Rrjedhimisht, librat e urdhërporosive të NEMO-s do të rihapen në **HH:MM**, saktësisht **10 minuta**.

Prandaj, publikimi i rezultateve të Bashkimit të Tregut do të vonohet.

Çmimet e larta/të ulëta janë konstatuar për zonat e ofertimit dhe Njesive Kohore te Tregut (MTU) te mëposhtme:

<i>Zona Ofertuese</i>	<i>E lartë/ E ulët</i>	<i>MTU- te e prekura</i>
<i>Shqipëri (AL)</i>		
<i>Kosove (KS)</i>		

Sugjerime mbi futjen ose modifikimin e urdhërporosive:

Në rast se fillon një Ankand i Dytë, Anëtarët e Bursës janë të autorizuar të rregullojnë urdhërporosinë e tyre sipas rregullave të mëposhtme:

a) *Për të gjitha orët për të cilat janë arritur kufijtë e lejuar:*

- *Në rast çmimesh të larta: shtoni volume shitjesh, hiqni volumet e blerjeve, ulni çmimet e urdhërporosive të shitjes dhe/ose blerjes;*

- *Në rast të çmimeve të ulëta: shtoni volume blerjesh, hiqni volumet e shitjeve, rrisni çmimet e urdhërporosive të shitjes dhe/ose blerjes.*

b) *Për të gjitha orët për të cilat nuk janë arritur kufijtë e lejuar:*

- *Modifikimi i urdhërporosisë autorizohet nëse Anëtarët e Bursës mund të justifikojnë synimin për të përmirësuar situatën e zonës ofertuese dhe orët, për të cilat janë arritur kufijtë e lejuar.*

Shënim: Oraret shprehen si orare CET!

Shënim: NEMO do ta zëvendësojë kohën në tekstin e komunikimit si më poshtë:

-HH:MM me kohën e vendosur në IC për rihapjen e librave të urdhërporosive (p.sh.....)

NEMO mund të shtojë pjesën e poshtme të mesazhit (seksionin italic) dhe të plotësojë tabelën si më poshtë:

- Hiqni me vije zonat ofertuese qe nuk jane prekur; - Shto "I lartë" ose "I ulët" për secilën zonë të ndikuar të ofertimit, në varësi të shenjës së kufijve të lejuar të arritur; - Shtoni orët ku çmimet tejkalojnë kufijtë e paracaktuara për çdo zonë ofertimi të ndikuar.

ALPEX_Exc_02: Vonesa në publikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut

Nëse Konfirmimi pozitiv Paraprak Global nuk është gjeneruar deri në orën 12:15, Ofruesi i Shërbimit MC do t'u dërgojë NEMO mesazhin e jashtëm *ALPEX_Exc_02* për ti komunikuar vonesën e mundshme.

Ky mesazh **nuk do t'i përcillet kurrë** Anëtarëve të Bursës përpara orës 12:25 ose nëse Konfirmimi pozitiv Paraprak Global është gjeneruar midis orës 12:10-12:25.

Nëse Konfirmimi pozitiv Paraprak Global gjenerohet ndërmjet orës 12:10-12:25, NEMO **nuk** do ta përcjellë këtë mesazh dhe sesioni i Bashkimit të Tregut vazhdon si normalisht.

Nëse Konfirmimi pozitiv Paraprak Global ende nuk është gjeneruar deri në orën 12:25, NEMO mund ta përshtatë dhe t'ua përcjellë këtë mesazh Anëtarëve të tyre të Bursës, OST-ve ose palëve të tjera të interesuara..

Shënim: Si përjashtim, Ofruesi i Shërbimit MC nuk do të dërgojë mesazhin *ALPEX_Exc_02* nëse:

- një Ankand i Dytë është aktivizuar nga mesazhi *ALPEX_Exc_01* përpara orës 12:15.

[ALPEX_Exc_02]: Vonesa në publikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut

Koha e dërgimit:

NEMO do ta dërgojë këtë mesazh në orën e zakonshme ditore të publikimit (12:25) nëse Rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk janë publikuar ende.

Përmbajtja e mesazhit:

Ju lutemi kini parasysh se **publikimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut do te shtyhet** deri në një njoftim të mëtejshëm.

Rezultatet e Bashkimit të Tregut do të publikohen sapo të jenë të disponueshme.

Nëse është e nevojshme, do të dërgohet një mesazh tjetër për vonesën.

ALPEX_Exc_03b: Vonesa e mëtejshme e Sesionit së Bashkimit të Tregut

Nëse Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut nuk janë publikuar ende për shkak të problemeve teknike 30 minuta përpara (afati i fundit për Ndarjen e Plotë - Rasti 1) ose nëse çështja që mund të shkaktojë një Ndarje te Plotë e njohur ne avance nuk është zgjidhur ende 30 minuta më parë (afati i fundit per Ndarjen e plotë– Rasti 3), Ofruesi i Shërbimit MC do t'i dërgojë NEMO-s mesazhin e jashtëm *ALPEX_Exc_03b* në mënyrë që të komunikojë rrezikun e një Ndarje të Plotë.

I njëjti mesazh do të dërgohet për të dy rastet e Ndarjes së plotë, përpara afatit përkatës të treguar në tabelën 2 në seksionin Përmbledhja e mesazheve.

NEMO-t mund ta përshtatin dhe t'ia përcjellin këtë mesazh Anëtarëve të tyre të Bursës, OST-ve ose palëve të tjera të interesuara.

Titulli i mesazhit:

[ALPEX_Exc_03b]: Vonesa të mëtejshme të sesionit të Bashkimit të Tregut

Koha e dërgimit:

Mesazhi ALPEX_Exc_03b duhet të dërgohet nga Ofruesi i Shërbimit MC dhe NEMO mund ta përcjellë atë 30 minuta, 15 minuta dhe 20 minuta përpara rastit të një Ndarje të Plotë si më poshtë:

- Në rastin e rrezikut të një Ndarje të Plotë -Rasti 1
- Në rastin e rrezikut të një Ndarje të Plotë -Rasti 2
- Në rastin e rrezikut të një Ndarje të Plotë -Rasti 3

ALPEX_Exc_04b: Ndarje e Plotë e lidhur me Rezultatet e Bashkimit të Tregut

Nëse Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut nuk publikohen deri në orën 14:20 (Afati i fundit i Ndarjes së Plotë, Rasti FD1), IC do të deklarojë Ndarjen e plotë dhe Ofruesi i Shërbimit MC do t'i dërgojë mesazhin e jashtëm ALPEX_Exc_04b NEMO-s, në mënyrë që të komunikojë Ndarjen e Plotë.

NEMO mund ta adaptojë dhe t'ua përcjellë këtë mesazh Anëtarëve të Bursës, OST-ve ose palëve të tjera të interesuara.

Titulli i mesazhit:

[ALPEX_Exc_04b]: Ndarja e Plotë

Koha e dërgimit:

Ofruesi i Shërbimit MC do të dërgojë dhe NEMO do ta përcjellë këtë mesazh në orën 14:20 (Ndarjen e plotë – Rasti FD1).

Përmbajtja e mesazhit:

Për arsye teknike ose probleme tregtimi, e gjithë Zona e Bashkimit të Çmimeve është në ndarje të plotë.

Ju lutemi ndiqni rregullat lokale të ankandit të NEMO-s.

ALPEX_Exc_04b: Ndarje e Plotë lidhur me dërgimin me vonesë të Kapaciteteve Ndërkufitare

Nëse kapacitetet ndërkufitare nuk dërgohen deri në orën 11:30 (Afati Ndarjes së Plotë të së rastit FD2), IC do të deklarojë Ndarjen e Plotë dhe Ofruesi i Shërbimit MC do t'i dërgojë mesazhin e jashtëm ALPEX_Exc_04b NEMO-s, në mënyrë që të komunikojë Ndarjen e Plotë.

NEMO mund ta adaptojë dhe t'ua përcjellë këtë mesazh Anëtarëve të Bursës, OST-ve dhe CAO

Titulli i mesazhit:

[ALPEX_Exc_04b]: Ndarja e Plotë

Koha e dërgimit:

Ofruesi i Shërbimit MC do të dërgojë dhe NEMO do ta përcjellë këtë mesazh në orën 11:30 (Afati i fundit per Ndarjen e plotë, Rasti FD2).

Përmbajtja e mesazhit:

Për arsye teknike ose probleme tregtimi, e gjithë Zona e Bashkimit të Çmimeve është në ndarje të plotë.

Ju lutemi ndiqni rregullat lokale të ankandit të NEMO-s.

ALPEX_Exc_05b: Ndarje e Plotë e njohur në avancë

Për të komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me palët e interesuara (Enteve Rregullatore, OST-ve, CAO dhe Anëtarët e Bursës) dhe për një deklaratë të përbashkët për shtyp në lidhje me Ndarjen e plotë.

Sapo IC të deklarojë Ndarjen e Plotë të njohur në avancë Ofruesi i Shërbimit MC do të dërgojë një mesazh të jashtëm ALPEX_Exc_05b te NEMO.

Ky mesazh mund t'u përcillet nga NEMO tek Anëtarëve të Bursës, OST-ve, CAO.

Titulli i mesazhit:

[ALPEX_Exc_05b]: Ndarje e Plotë e njohur në avancë

Koha e dërgimit:

Mesazhi i Ndarjes së Plotë i njohur në avancë dërgohet nga Ofruesi i Shërbimit MC dhe përcillet nga NEMO sapo IC të deklarojë Ndarjen e Plotë te njohur në avancë, por jo më vonë se ora 10:00.

Përmbajtja e mesazhit:

Për shkak të problemeve të rënda, që vazhdojnë pas Ndarjes së plotë të sesionit të mëparshme të Bashkimit të Tregut, **e gjithë Zona e Bashkimit të Çmimeve do të mbetet në ndarje të plotë për ditën e livrimit DD.MM.VVVV.**

Ju lutemi ndiqni rregullat lokale të ankandit të NEMO-s

Shënim:

Ofruesi i Shërbimit MC do ta zëvendësojë kohën në tekstin e komunikimit si më poshtë:

DD.MM.VVVV me ditën përkatëse të livrimit (p.sh. 20.05.2013)